



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr.26

Prishtinë, më 23.11.2015 ora: 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

i mbledhjes së Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaqi dhe Alma Lama.

Munguan: Shqipe Pantina, Pal Lekaj, Jelena Bontic dhe Zafir Berisha.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit: ZPRK, OSCE, BIRN, KDI, D4D, Shoqata e Juristëve "Norma", RTV21, Kosovapress, Avonet.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative;

Komisioni filloi me shqyrtimin nga neni 40 i tekstit të P/ligjit dhe shqyrtimin e propozimeve të hartuara nga grupi punues i komisionit si në vijim:

Neni 40. Në lidhje me nenin 40 deputetët paraqesin propozimet e tyre me shkrim në mbledhjen e radhës.

Përkufizimet se çka janë aktet reale, ç'është procedura administrative dhe Prestacioni?

Neni 40 paragrafi 3. Të sqarohet nga MAP.

Neni 46, paragrafi 3, ndryshohet si vijon: Me kërkesë, organi publik konfirmon pa vonesë, në formë të shkruar, përmbajtjen e aktit verbal apo aktit të miratuar në heshtje të përcaktuar në nenin 70 të këtij Ligji, pa i paragjykuar rregullat mbi pasojat juridike të akteve administrative. Paragrafi 2 i këtij neni zbatohet përshtatshmërisht edhe në këtë rast.

Neni 48. 1. Riformulohet: Arsytimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsytimi përmban:

Neni 58 paragrafi 2. Anulimi apo shfuqizimi, në çdo rast tjetër mund të bëhet brenda 30 ditëve nga data kur organi publik i përcaktuar sipas paragrafit 1 të nenit 53 të këtij Ligji, njihet me faktet që justifikojnë anulimin apo shfuqizimin, por jo me vonë se 5 vjet nga njoftimi i aktit administrativ.

Neni 62.3. Përkufizimi “Prestacion” nga ligji për detyrimet.

Neni 67. Për aq sa nenet 60, 61, 62, 63, 64, 65 dhe 66 të këtij Ligji nuk e parashohin ndryshe, dispozitat e tjera të këtij Ligji për aktin administrativ si edhe dispozitat e ligjit për marrëdhëniet detyrimeve, do të zbatohen, përshtatshmërisht, edhe për interpretimin, vlefshmërinë si dhe zbatimin e kontratës administrative.

Neni 69, paragrafi 2, ndryshohet si vijon: “Një akt real është i ligjshëm nëse është kryer nga organi kompetent, në pajtim me parimet dhe dispozitat e këtij Ligji, të cilat zbatohen përshtatshmërisht për aktet reale”.

Neni 75. Titulli i nenit 75 ndryshon në “Kërkesat e parashtruara te organi jokompetent”.

Neni 75, paragrafi 2, fjalia e fundit ndryshohet si vijon: “Paragrafi 2 i nenit 46 të këtij Ligji zbatohet përshtatshmërisht edhe në këtë rast.”

Neni 77, ndryshohet si vijon: Dispozitat e këtij Ligji mbi formën, përmbajtjen dhe parashtrimin e kërkesës fillestare, do të zbatohen, përshtatshmërisht, për çdo aplikim, petition, propozim, ankesë, kundërshtim, deklaratë apo çdo lloj tjetër parashtrëse, që palët i drejtojnë një organi publik

Neni 80 paragrafi 1. Shqyrtimi i kërkesës për rivendosjen në afat është në kompetencën e organit publik kompetent për çështjen administrative në fjalë. Ky i fundit (vendos) brenda 10 (dhjetë) ditësh nga parashtrimi i kërkesës.

Neni 80 paragrafi 2. Shprehja “për shkak të ligjit”, zëvendësohet me shprehjen ”sipas ligjit”.

Neni 82, paragrafi 4. Në rast të kërkesave të parashtruara gabimisht, siç parashihet me paragrafin 1 të nenit **68 zv. me nenin (75)** të këtij Ligji, afati kundrejt parashtruesit do të vlerësohet si i respektuar nëse kërkesa është parashtruar brenda afatit (në kohe) pranë organit publik jokompetent, ndërsa afati përkatës kundrejt organit publik kompetent do të fillojë të përlllogaritet tri ditë pas parashtrimit të kërkesës pranë organit jokompetent.

Neni 85 paragrafi 3. Reformulohet “Kur procedura për zgjidhjen e çështjes paraprake mund të fillohet **vetëm sipas detyrës zyrtare** nga organi tjetër, organi për zgjidhjen e çështjes do të kërkoj nga organi tjetër fillimin e procedurës për zgjidhjen e çështjes paraprake”.

Neni 88, paragrafi 1. Organi publik, për të përcaktuar gjendjen e fakteve dhe rrethanat e ndërlidhura me çështjen, mund të përdorë çdo mjet prove të paraparë nga **ligji** për procedurën kontestimore.

Neni 91, paragrafi, 2 ndryshohet si vijon: Në këtë rast zbatohen, përshtatshmërisht, dispozitat e këtij Ligji për ndihmën administrative ndërmjet organeve publike.

Pritet propozimi për riformulimin e nenit 100.1.

Neni 100 paragrafi 1. Nëse pala ka kërkuar nxjerrjen e një akti administrativ të shkruar dhe organi publik **nuk e njofton palën për aktin administrativ** brenda afatit fillestar dhe nuk njofton shtyrjen apo nuk njofton **për** aktin brenda afatit të shtyrë, sipas nenit 98 gjegjësisht 99 të këtij Ligji, kërkesa e bërë nga pala do të vlerësohet e pranuar në tërësi dhe akti administrativ i kërkuar nga pala do të vlerësohet të jetë miratuar (në vijim: "akti administrativ i miratuar në heshtje"). Të harmonizohet teksti i gj. angleze me tekstin në gj. shqipe

Neni 100, paragrafi 4 ndryshohet si vijon: Dispozitat e këtij Ligji për pasojat juridike, ligjshmërinë, shfuqizimin dhe anulimin e akteve administrative, si dhe për mjetet juridike zbatohen, gjithashtu, përshtatshmërisht edhe për aktin administrativ të miratuar në heshtje.

3. Të ndryshme.

Pasi për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime, mbledhja përfundoi.

Mbledhja përfundoi në ora: 12:45.

E përgatiti :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit
Zenun Pajaziti**
